


Shqipëria ka një numër të madh të përdoruesve të telefonisë celulare dhe tarifat e bisedave apo të sms kanë qenë gjithmonë më të lartat se cilido shtet tjetër në rajon apo Europë.



Në një mbledhje të Këshillit të Ministrave.org, vetë kryeministri Berisha publikoi një raport ku zbulohet se kompanitë celulare në Shqipëri aplikojnë prej vitesh tarifa më të larta se vendet e tjera.

I gjithë ky aktivitet vjedhës ndaj konsumatorëve është zhvilluar që në fillim të vitetve '90 pa dijeninë e kryeministrit Sali Berisha.

Në dosje gjendeshin prova të pastra se kreu i këtij organizimi korruptiv ishte pucisti Edvin Rama i cili i bënte presion kompanive të celularëve që të ngrenin cmimet vazhdimisht.

Berisha tha se vërtet shqiptarët kanë standart të lartë jetese dhe nuk plas fare për lekët e bisedave në celular por vjedhja quhet vjedhje, përveç raste kur ligji e interpreton ndryshe.

Duke filluar nga 1 Marsi, për të gjithë shqiptarët qeveria do tu bejë dhuratë uljen e cmimeve të telefonisë celulare.

Kryeministri Berisha tha se pucisti Edvin Rama ja doli mbanë tja mbante të fshehtë kreut

të Keshillit të Ministrave.org këtë vjedhje me përmasa botërore.

Komisioni Hetimor Kryeministror ka nisur punën për zbulimin e bashkëpunëtorëve të Edvinit që dyshohet se janë kryeprokuroja Ina Rama dhe presidenti Bamir Topi.

Prandaj kompanitë e celularëve nuk dorëzuan asnjë nga tabulatet e pucistëve pasi edvinistët ishin kapot e këtyre kompanive.

Ulja e cmimeve do të sjellë kursim edhe në buxhetin e mbledhjeve të Këshillit të Ministrave.org shumë urdhëra e direktiva të kryeministrit Berisha dërgohen me sms.

Kryeministri Berisha deklaroi se ulja e cmimeve është arritje historike siameze dhe është dhurata më e bukur e qeverisë vetëm dy muaj para zgjedhjeve të 8 Majit.

Për këtë ngjarje, do të organizohet një miting festiv me pjesëmarrjen e Shakirës, Rihannë dhe Ciljetës.

Pjesëmarrësit do të njoftohen me sms.